



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 22 datë 4.4.2023

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË FINANCIMIT NGA FONDI SHQIPTAR I
ZHVILLIMIT (FSHZH) PËR RIKUALIFIKIMIN E FASADAVE TË DISA
PALLATEVE NË QYTETIN SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 4.4.2023, me propozim të Kryetarit të Këshillit Bashkiak, mbështetur në nenin 8, pika 1, nenin 9 pika 1, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak Shkodër”, shkresës nr.904/1, datë 17.3.2023, të FSHZH,

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të financimit nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për rikualifikimin e fasadave të disa pallateve në qytetin e Shkodrës me vendndodhje sipas hartave bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi, si dhe për nënshkrimin e marrëveshjes përkatëse me FSHZH, si dhe lejeve administrative të nevojshme konformë legjislacionit në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

K R Y E T A R


Brisela KADIJA

Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 5.4.2023